



| | | | |
|--|------|--|----------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO | | | |
| MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE | | | |
| Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit | ARPL | Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No. | 709-2/24 |
| Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages | 4 | Data: Datum: Date: | 15.04.24 |
| PRISHTINË / A | | | No. 1 |

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

| | |
|------------------------|---|
| DATË/A: | 19.03.2024 |
| REFERENC-Ë: | 709/24 - ZSP- 2024 |
| PËR/ZA/TO: | DUKMM, K. KAÇANIK |
| CC: | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | Z. Izedin BYTYQI , Zëvëndësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së Z. Naser AFIZI, Zëvëndësues i drejtorit të ARPL- së Znj. Makfirete DIBRANI, Udhëheqëse e DMRU-së |
| NGA/OD/FROM: | Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të drejtën ujore |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Vendim - Pëlqim Ujor |

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën dhe Dokumentacionin tekniko-investiv, me Nr. të protokollit: 709/24, datë 08.02.2024, parashtruar nga Drejtor i Drejtorisë për Urbanizem Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit, K.KAÇANIK dhe ka vendosur si në Pëlqimin Ujor, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

PU

Datë: 19.03.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ, MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:


PËLQIM UJOR

APROVOHET kërkesa e palës, **Drejtoria për Urbanizem Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit, K. Kaçanik** për Pëlqim ujqor, për urën mbi Lumin Nerodime, në Zonën Urbane, në ngastrat me nr P-70917048-00650-1, Zona kadastrale Kaçanik dhe P-70917048-01846-2, Lumi Nerodime, njësia kadastrale Kaçanik;

Pëlqimi Ujqor jepet me këto kushte :

1. Pëlqimi Ujqor lëshohet në bazë të dokumentacionit investivo-teknik i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi, dhe si i tillë ruhet nga pala, K. Kaçanik;
2. Pëlqimi Ujqor vlenë vetëm për ndërtimin e pjesëve përbërëse të konstruksionit të urës;
3. Pala gjatë fazës së ndërtimit duhet t'i nënshtrohet rregulloreve teknike të zhvillimit të punimeve hidroteknike, duke përfshirë edhe masat mbrojtëse mbi dhe nën rrjedhën e poshtme, të ujërrjedhjes;

Faqe 2 nga 4



4. Nëse gjate fazës së ndërtimit vije gjërë të çrregullimi i regjimit uJOR, gjërë të proceset erroduese në shtrat të lumit nga infrastruktura uJore, e kjo shkakton dëme te çfarëdo karakteri, pala është e obliguar që shkaqet e dëmit t'i eliminoj, kurse dëmet t'i kompensojë;
5. Të gjitha makineritë ndërtimore, duhet të përdoren në harmoni me normat dhe praktikat mjedisore të mbrojtjes, nga derivatet e naftës;
6. Pëlqimi uJOR nuk paraqet të drejtën pronësore, ose të drejtën për shfrytëzimin e tokës, respektivisht të objekteve dhe pajisjeve të cilat nuk janë në pronësi të bartësit të pëlqimit uJORë;
7. Validiteti i Pëlqimit UJOR pushon në rast të mos plotësimit të këtyre kushteve të lartë cekura, në afatet e parapara kohore;
8. Nëse me Plane për menaxhimin e pellgjeve lumore, parashihet diçka tjetër në atë vend, pala është e obliguar që objektin ta largoj, si dhe llogaritë financiare bien mbi palën;
9. Vlefshmëria e pëlqimit uJORë është dy vite, nga data e lëshimit të tijë, nese deri në këtë datë nuk është siguruar leja ndërtimore dhe fillimi i punimeve.

ARSYETIM

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje UJore, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim: Kërkesën për pëlqim uJOR për kalim mbi pronën uJore, në K.Kaçanik; pagesa e fatures me rastin e aplikimit sipas shtojces me nr 6 për aplikim; Certifikatën e pronësisë për pronën P-70917048-01845-2 , evidentuar si pasuri e K. Kaçanik dhe P-70917048-01846-2, e videntuar, Lumi Nerodime P. Sh. e ujërave; Projekti kryesor – Ura mbi Lumin Nerodime K. Kaçanik, hartuar nga Urban 3D Sh.p.k. K. Ferizaj; Certifikata e regjistrimit të biznesit e kompanise hartuese te projektit (71233731) dhe nr fiskal; Diploma e kualifikimit universitar, Xhelal Hysni Musa; Përmbajta e dokumentacionit teknik dhe pjesa grafike;Paramasa dhe parrallogaria; Projekti kryesor etj;

Arsyeja e ndërtimit të urës të paraparë për ndërtim mbi lumin Nerodime është se, nga ekspertet komunal është vërtetuar se aftësija mbajtëse e urës egzistuese nuk është në gjendje të volitëshme dhe se është e pakalueshme për shumë automjete, por edhe e rrezikshme për këmbësor, poashtu ura e re e parapre do te lidh objektet e rëndësisë për K. Përkatëse, Ura do të shërbejë për lidhjen në mes të dy pjesve të qytetit të cilat ndahen nga po Lumi Nerodime; Andaj bazuar në dokumentacionin Tekniko –investiv të dorëzuar, shikimit në vend , me datë 14.03.2024 , me ç'rast është mbajtur procesverbali dhe është nëshkruar nga përfaqësuesit e Komunës Kaçanik dhe zyrtarëve të ARPL-së, është vendosur si në dispozitiv të këtijë vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.



KËSHILLA JURIDIKE :

Pala e pakënaqur, ka të drejtë në inicimin e procedurës së Kontestit administrativ, në Gjykatën Kompetente të Kosovës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 709/24 - ZSP- 2024, datë: 19.03.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Kaçanik
- Arkivit të Ministrisë.

Zavendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së



Izedi BYTYQI